Komiteti për Politikë dhe Financa, me 6 vota PËR, pas shqyrtimit të kërkesës së lartpërmendur, rekomandoi që kërkesa të dërgohet për shqyrtim të mëtutjeshëm në Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, si dhe në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, drejtorit në fjalë të sjellin në Kuvend një elaborat sa i përket kërkesës së parashtruar nga banorët e këtyre fshatrave, në mënyrë që Kuvendi ta shqyrtojë më tutje kërkesën.

Kërkesa 2.

Kërkesë nga shoqata e peshkatarisë "Ujëvarat e Mirushës" të cilët theksojnë: Me këtë kërkesë, i drejtohem Kuvendit të Komunës së Klinës, që për turneun e "peshkatarisë" i cili mbahet për nder të shënimit të Ditës së Çlirimit të Klinës, të përkrahet me mjete financiare me vlerë prej 1.500.00 (Njëmijepesëqind euro)

Mjetet te cilat do të përdoren për:

- Organizimin dhe mbajtjen e turneut, duke përfshirë edhe ndarjen e çmimeve për garuesit fitues;
- Manifestimin e kësaj dite;
- Rregullimin dhe pastrimi i hapësirës ku do mbahet turneu;
- Ushqyerja e peshkut në këtë periudhë kur ushqimi është i pakët, dhe kontrollimi i peshkimit të jashtëligjshëm nga ekipi kontrollues nga SH.P “Ujëvarat e Mirushës”.

Fadil Gashi, Kryesues: Unë jam për t’iu ndihmuar, urdhëro, Tunë Dedaj?

Tunë Dedaj: Edhe unë jam për t’iu ndihmuar, por mos me jua dhanë 1500 euro se nuk ju shkojnë aq shumë, me jua dhanë 1000 euro, se nuk ka ndonjë shpenzim të madh aty për atë ditë.

Fadil Gashi, Kryesues: Mirë, a ka dikush tjetër?

Mendehie Duraku: Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë! Unë mendoj që nëse kjo kërkesë me këtë shumë të kërkuar është për një vit, atëherë nuk janë shumë 1500 euro të ju ndahen, nuk jam e pajtimit 1000 por të jetë 1500 se gjatë një viti besoj që ju duhen mjete, faleminderit!

Tunë Dedaj: Kjo është vetëm për atë ditë që mbahet turneu.

Fadil Gashi, Kryesues: Veç një, pa dashtë me paragjykuar a 1000 a 1500, e para po kuptoj që ne jua kemi dhanë këtë ditë vet me vendimin tonë edhe ju kemi thënë që do t’i mbështesim, edhe këtyre është mirë tash në vendimin tjetër me jua lëshuar sikur ata të parin, me na sjellë raportin, edhe e paskemi lehtë sepse në vendim në pikën e tretë e kemi thënë se, turneu do të organizohet nën përkujdesjen e komunës së Klinës, përkatësisht Drejtorisë së Bujqësisë, le ta kontrollojnë këta çdo cent, në përkujdesje të tyre qenka.

Tunë Dedaj: Kryesues, si ta vendosësh unë e përkrahi, nuk është problem. Veç mu duk e tepërt se aty nuk ka ndonjë shpenzim të madh, në bazë të shkresave për një ditë është ajo, nuk është për një javë.

Mendehie Duraku: A mundemi ne tash, pak a shumë me marr një vendim ose në Kuvend e marrim që, me cilën shumë të vendosim, çdo vit këta e kanë këtë turne, të jetë gjithë kjo shumë e ndarë prej komunës, se këta nëse sot kanë shkuar me 1500 euro nesër mund të na vijnë me 2000, vitin tjetër mund të na vijnë me më shumë. Tash, thjeshtë ta dimë a e bëjmë si vlerë që duhet të mbetet ashtu 1500 ose 1000 për çdo vit gjatë turneut, se nëse sot ja japim 1500, ndoshta vitin tjetër vijnë me 2000.

Fadil Gashi, Kryesues: Shiko, kjo që po thotë Mendehia ndoshta është e mirë, por ndoshta kishte me qenë mirë edhe sivjet ne me vendos kështu edhe vitin tjetër me na sjellë kërkesën Drejtoria e Bujqësisë. A ka dikush tjetër?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga shoqata e peshkatarisë për mbështetje financiare, me 6 vota PËR, rekomandoi që për organizimin e këtij turneu tradicional të ndahen mjete buxhetore në vlerë prej 1000 euro (njëmijë euro). Gjithashtu, rekomandoi që shoqata e peshkatarisë, pas përfundimit të turneut, të sjellë raport të shpenzimeve të këtyre mjeteve në Kuvend.

Kërkesa 3.

Nga tri Organizatat e dala nga lufta e UÇK-së, Degët-Klinë, të cilët theksojnë: Duke pasur parasysh gjendjen e rëndë të Organizatave të dala nga lufta e UÇK-së, degët në Klinë, të cilat që nga themelimi i tyre nuk kanë kurrfarë burimi financiar institucional për funksionimin e tyre. Në Organizatat e dala nga lufta e UÇK-së, degët në Klinë kërkojmë nga kryetari i komunës konform kompetencave që ka, të merr vendim për mbështetje të rregullt financiare për funksionimin e këtyre shoqatave. Në bazë të përlllogaritjeve tona, për funksionimin e tri organizatave, na duhet mbështetjefinanciare vetore në shumë prej 15 000.00 euro (Pesëmbëdhjetëmijë euro)

Arsyetim

Në këtë shumë të mjeteve të kërkuara janë përfshirë: pagat për stafin e tri organizatave, shpenzimet për administratë, shpenzimet për përvjetorë, shpenzimet për vizita të familjeve të tri kategorive, shpenzimet për aktivitete të ndryshme në kuadër të datave të rëndësishme të UÇK-së në Komunën e Klinës dhe gjithë territorit të Kosovës e më gjerë. Mbesim me shpresë që kjo kërkesë do të merret parasysh si dhe të realizohet pozitivisht. Njëherit ju falënderojmë për mirëkuptim!

Fadil Gashi, Kryesues: Do të thotë, tash i bie ka 5000 për secilën shoqatë, me thënë të drejtën komunat tjera kanë këso vendime dhe i mbështesin, e kam këtu një vendim të komunës së Prishtinës që po i mbështetke kështu. Ne po e pranojmë si të mirëqenë këtë kërkesë edhe kur ta bëjmë buxhetin, neve nuk na bëjnë gjë për 15.000 euro. Po, urdhëro, Tunë Dedaj?

Tunë Dedaj: Kryesues, kjo është e domosdoshme për me ju ndarë, por këtë është dashtë Qeveria, me qenë fondi i ndarë për ta, me qenë në nivel të Kosovës, po edhe nëse marrim një vendim me jua ndarë është mirë me na raportuar se ku i kanë dërguar paratë, se 15.000 euro nuk janë pak, se janë para të taksapaguesve tonë. Unë kam dëshirë të ju ndihmojë, është mirë të ju ndihmojmë por është dashtë të jetë në vijë buxhetore prej Qeverisë me ju dhanë gjithëve në mënyrë të njëjtë në krejt Kosovën, edhe mos m'i lënë në mëshirën e dikujt tjetër gjithmonë me kërkesa, edhe nëse e bien vendim me na ndarë është mirë me na raportuar paratë e vitit të kaluar se edhe vjet jua kanë ndarë paratë këtyre, m'i raportuar ku i kanë dërguar, ku janë shpenzuar ato para.

Fadil Gashi, Kryesues: Unë jam ithtar edhe kam qenë gjithë, që të kemi raport se ku shkojnë mjetet e Kuvendit, këto që i ndajmë ne si Kuvend, edhe me sjellë raport kthyes është kulturë në fund të fundit, edhe nëse nuk është kërkesë ligjore, është kulturë, transparencë; atë që ta jap unë, ti më tregon se ku e ke dërguar, si e ke shpenzuar, në cilat fusha është investuar, me çka është

mirëmbajtur? Shpenzimet duhet të bëhen me fatura, me mbulesa, me arsytetime. Por, ne po bisedojmë, ne e rekomandojmë për në Kuvend, do të debatojmë edhe në Kuvend bukur seriozisht. Kush është për?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga tri Organizatat e dala nga Lufta e UÇK-së për mbështetje financiare, me 6 vota PËR, rekomandoi që kërkesa të kalojë për shqyrtim në Kuvend.

Pika 5. Propozim-vendimi i kryetarit të komunës z. Zenun Elezaj, për subvencionim të qirasë së banimit për znj. Nazife Gucati.

Kërkesë nga Zyra e Kryetarit të Komunës, nga e cila kërkojnë që të hyjë në rend të ditës në mbledhjen e KPF-së të datës: 20.03.2023 kërkesa e palës Nazife (Bajram) Gucati nga Klina, që ka të bëjë me ndarjen e mjeteve financiare për pagesën e qirasë mujore për një periudhë të caktuar një vjeçare me propozim nga 150 € në muaj.

Ku theksohet me rastin e pranimit të kërkesës së palës Nazife Gucati, kërkesa nr.01-553-995/2023 e datës 10.01.2023, ne si ekzekutiv kemi shqyrtuar mundësitë financiare dhe ju njoftojmë se jemi të gatshëm që pas konfirmimit tuaj t'i lejohet ndarja e mjeteve financiare për pagesën e qirasë mujore për periudhën 1 vjeçare në shumë prej 1,800 € (njëmijë e tetëqind euro) deri në gjetjen e një zgjidhje të familjes së përmendur.

Parashtruesja e kërkesës jeton nga ndihma sociale dhe ka probleme familjare sipas dokumentacionit të parashtruar.

Andaj, mbi këtë gjendje duke u bazuar në dokumentacionin mbështetës të kërkesës së palës, kërkojmë nga ana juaj që të rekomandohet për Kuvend marrja e vendimit për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 1,800 € (njëmijë e tetëqind euro) për familjen e parashtrueses së kërkesës.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga Zyra e Kryetarit të Komunës, që ka qëllim subvencionimin e qirasë së banimit për znj. Nazife Gucati, me 6 vota PËR, rekomandoi që kërkesa të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend, ashtu siç është rekomanduar nga Zyra e Kryetarit të Komunës.

Pika 6. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Klinës.

Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, kryesuesi i Komitetit, z. Fadil Gashi, theksoi se kjo është një Draft-Rregullore e cila është model unik në të gjitha komunat, por deri në miratimin e këtij drafti mund të ndryshojmë përmbajtjen dhe çdo gjë brenda saj, në mënyrë që të jetë sa më lehtë e aplikueshme për të gjitha kategoritë të cilat i atakon. Po ashtu, Komiteti për Politikë dhe Financa,

pas shqyrtimit të Draft-Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Klinës, rekomandoi:

1. Ndryshimin e nenit 23 të draft-rregullores, paragrafi 1 pika 1.1 Kategoria e konsumatorëve shtëpiak- amvisëritë do të paguajnë tarifë fikse prej 6.5 € në muaj.

- **REKOMANDIM, Çmimi i kësaj tarife nga 6.5 euro sa parashihet në Draft-Rregullore të ulet në 6 euro në muaj.**

2. Gjithashtu, të ndryshohet pika 1.1.4 Nënkatëria e katërt: subjektet e mesme deri të mëdha komerciale/industriale me kosto të lartë të shërbimit do të paguajnë tarifë fikse prej 35.00 € në muaj.

- **REKOMANDIM, Çmimi i kësaj tarife nga 35 euro sa parashihet në Draft-Rregullore, të ngrihet në 40.00 euro në muaj.**

-Po ashtu, u rekomandua të rishikohet neni 24 për faturimin e mbeturinave për mënyrën e pagesës dhe kështu mujore.

Tunë Dedaj: Unë kisha me u angazhuar në maksimum, me jua rritë ndërmarrjeve dhe jam prej atyre që vet kam firmë private, se te ndërmarrjet është shuma shumë e vogël në krahasim me mbeturinat që i bëjnë ata, dmth jo me jua rritë për dy euro, por për pesë euro ose dhjetë euro, se është krejt normale, se ata fitojnë dhe kanë mundësi, sepse në krahasim me familjarët këta bëjnë mbeturina pesë herë më shumë. Pra, propozimi im komplet është me jua bërë ndërmarrjeve të vogla dhjetë euro, se i kanë mundësitë të paguajnë dhjetë euro në muaj.

Kur e them kështu, e them se unë jetoj në Shëngjin, edhe atje paguaj për dy vende, për restorant veç e për hotel veç, edhe është shuma pesë herë më e madhe se këtu, e nëse ekonomia familjare është e obliguar të paguajë 6.50, atëherë përse ndërmarrja t'i paguajë veç dy euro më tepër? P.sh., unë e kam një propozim konkret që, shkollat dhe objektet fetare të lirohen, mos t'i paguajnë mbeturinat, se ato nuk marrin para prej shtetit, marrin para prej popullit, ky është propozim i imi, por ndoshta unë në fund të fundit pajtohem me ju, si e merrni vendimin ju.

Fadil Gashi, Kryesues: Kjo pjesa e parë, unë po insistoj në debat me qytetarin kur të mbahet sepse nëse na vjen qoftë një anëtar i biznesit na ndihmon shumë kjo që po e thua për Shqipërinë, sepse e jep një përvojë tënden me një praktikë që përdoret në një shtet tjetër, edhe ndoshta e bën për ta menduar edhe biznesin që vjen këtu në debat, a ka dikush tjetër?

Tunë Dedaj: Pasi është rreth këtij planit për mbeturina, unë e kam edhe një propozim: që komuna ta formojë një organizatë ose firmë për bartjen e mbeturinave të ngurta.

Fadil Gashi, Kryesues: Kjo është shumë e arsyeshme dhe këto që po i themi, ne, në fund do t'i votojmë, ndërmarrja me krejt atë staf, me krejt ato pajisje do të operojë veç në bazë të këtij dokumenti. Nëse ne nuk po i sanksionojmë këto qysh po i themi, kot ne flasim, ata s'mund të dalin jashtë kësaj, nëse ne ja sanksionojmë këto, unë po besoj se ata janë të vetëdijshëm tani në implementim të kësaj rregullore, dikush tjetër?

Komiteti për Politikë dhe Financa, me 6 vota PËR, rekomandoi që Draft-Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Klinës së bashku me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet të cilat vijnë deri në seancë të shqyrtohen nga Kuvendi dhe më pas të miratohet.

Pika 7. Shqyrtimi i Draft-Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027.

Fadil Gashi, Kryesues: Këtë e kemi veç me lëshuar në diskutim, a ka dikush? Kush është për?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, me 6 vota PËR, rekomandoi që Draft-Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023-2027 të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 8 dhe 9. Shqyrtimi i propozimit për vënie në diskutim publik:

Draft-Strategjinë për komunikim dhe marrëdhënie me publikun 2023-2026.

Draft-Planin e veprimit për informim dhe komunikim 2023-2026.

Fadil Gashi, Kryesues: Bashkë me Draft- strategjinë është edhe Plani vjetor i veprimit, edhe kjo është për t'u lëshuar, dyjat janë të njëjta. Po, urdhëro, Vlora Tafili?

Vlora Tafili, (zyrtare për Informim): Përshëndetje Kryesues, Ahmet, Monikë dhe ju anëtarë të KPF-së! Këto dyja e kanë një rëndësi goxha të veçantë, por, mos harroni t'i kushtoni pak vëmendje se ka kompetenca në përgjithësi edhe Kuvendi aty, plus ka implikime buxhetore, por, sidoqoftë ne do ta mbajmë bazuar në Udhëzimin Administrativ 30 ditë në diskutim publik dhe besoj që do të takohemi prapë. Nëse keni ndonjë pyetje, unë jam këtu, faleminderit!

Fadil Gashi, Kryesues: Faleminderit, kush është për?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të Draft-Strategjisë për komunikim dhe marrëdhënie me publikun 2023-2026 dhe Draft-Planit të veprimit për informim dhe komunikim 2023-2026, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, me 6 vota PËR, rekomandoi që këto dy draft- dokumente të kalojnë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend për vënie në diskutim publik.

Pika 10. Të ndryshme.

Fadil Gashi, Kryesues: Në të ndryshme, a ka dikush? Atëherë, po ju falënderoj shumë për pjesëmarrje dhe për angazhim. Shihemi në takimin e radhës.

Procesmbajtësja,
Monika Palushi

KRYESUESI,
Fadil Gashi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-kline.org

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim

**RAPORT I MENAXHIMIT FINANCIAR I KOMUNËS SË KLINËS PËR
PERIUDHËN JANAR-MARS 2023**

RAPORTI TREMUJOR ËSHTË PËRGATITUR BAZUAR NË LIGJIN NR. 03/L-048, MBI MENAXHIMIN E
FINANCIVE PUBLIKE DHE PËRGJEGJËSITË

1. Hyrje	3
1.1. Granti Qeveritar.....	3
1.2. Granti i të hyrave vetanake	3
1.3. Të hyrat vetanake të bartura.....	3
1.4. Performanca e shpenzimeve.....	4
2. Të hyrat buxhetore të komunës së Klinës për vitin 2023 duke i përfshirë edhe të hyrat nga donatorët sipas burimit të financimit	5
3. Të hyrat vetanake (sipas llojeve) të realizuara për periudhën janar-mars 2023 dhe krahasimi me periudhën e njëjtë të vitit paraprak	6
3.1. Realizimi i të hyrave për periudhën janar-mars 2023 sipas muajve	7
4. Shpenzimet buxhetore për periudhën janar-mars 2023 dhe krahasimi me vitin paraprak.....	8
4.1. Shpenzimet e buxhetit në periudhën janar-mars 2023 sipas kategorive ekonomike.....	9
5. Shpenzimet buxhetore për periudhën janar-mars 2023 - raportit të shpenzimeve analitike sipas kodeve buxhetore në SIMFK	11

1. Hyrje

Raporti për periudhën Janar-Mars 2023 është përgatitur në pajtim me dispozitat e nenit 45, paragrafët 45.2, 45.4 dhe 46.1 të Ligjit nr. 03/L – 048, për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Raporti i përgatitur paraqet buxhetin në SIMFK, shpenzimet dhe arkëtimin e të hyrave .

Raport financiar për buxhetin, të hyrat dhe shpenzimet për periudhën Janar – Mars 2023 është punuar për të analizuar realizimin e buxhetit në periudhën Janar – Mars 2023 do të japim një pasqyrë të buxhetit, të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore, do të analizojmë disa trende të këtyre kategorive buxhetore si dhe do të bëjmë disa krahasime me parametrat buxhetor për këtë periudhë dhe disa krahasime me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Buxheti sipas SIMFK për vitin 2023 duke përfshirë edhe të hyrat nga grantet e brendshme dhe te jashtme ishte 13,529,518.43 €, buxheti për këtë periudhë është më i lart për 19.58% se buxheti i vitit 2022.

Gjithsej pagesat kanë shënuar rritje prej 8.69% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, ku kontributin më të madh në këtë rritje gjatë kësaj periudhe e ka dhënë kategoria e shpenzimeve komunale, mallrave dhe shërbimeve dhe paga e medijtje.

1.1 Granti Qeveritar

Granti Qeveritar është burimi kryesor i financimit të buxhetit komunal, ku pjesëmarrja është 86.31% në periudhën janar-mars 2023 (shuma 11,677,821.00 €). Në raport me vitin paraprak buxheti nga GQ është 14.02% më i lart.

1.2 Granti I të hyrave vetanake

Të hyrat vetanake të komunës gjatë tremujorit të parë, janë arkëtuar në vlerën e përgjithshme vjetore 24.91 %, ndërsa kanë shënuar rënie prej 12.31 % krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Grumbullimi i të hyrave buxhetore gjatë këtij tremujori kanë arritur shumën prej 342,218.89 € (24.91 %) e buxhetit total në këtë periudhë, të hyrat tatimore dhe jotatimore kanë shënuar një rënie prej 12.31% që korrespondon me 48,020.67 € më pak në krahasuar me tremujorin e vitit paraprak.

1.3 Të hyrat vetanake të bartura

Buxheti nga THV të bartura të vitit 2022 gjatë periudhës Janar-Mars 2023 nuk është bartur në SIMFK

Përveç Grantit Qeveritar dhe THV si burime të rregullta të financimit, si burim të financimit në këtë periudhë kemi edhe donacionet e brendshme të bartura, participimet e qytetarëve dhe grante tjera siq janë :

- ❖ **Granti i donatorëve të brendshëm - Participimi i qytetarëve** në shumën prej 31,332.12 €, në raport me vitin paraprak buxheti nga ky grant është **516.52 %** (shuma 26,250.00€) më i lartë se në vitin paraprak. Ndikim në rritjen e këtij granti ka qenë bartja e donacioneve të brendshme në këtë vit shuma 20,082.12 € dhe 11,250.00 € janë të hyra nga donatorët e brendshëm të dedikuara për ndihmë ndaj të prekurve nga vërshimet.
- ❖ **Grante tjera të jashtme - Donacion i jashtëm** në shumën prej 18,341.33 €, mjete këto të grumbulluara për ndihmë ndaj të prekurve nga vërshimet.
- ❖ **Granti i përformancës** në total është shuma prej 776,403.11 €, në periudhën Janar-Mars 2023 i kemi të alokuara vetëm mjetet **nga DEMOS** në shumën prej **426,739.48 €**, ndërsa mjetet tjera në shumën prej 349,663.63 € pritet të alokohen në muajt e ardhshëm nga MAPL.

1.4 Performanca e shpenzimeve

Shpenzimet buxhetore në periudhën Janar-Mars 2023 në shumën prej 2,238,489.97 € krahasuar me shpenzimet për periudhën e njëjtë të vitit 2022 në shumën prej 2,059,491.93 € janë më të larta për 8.69 % . Ndikim në rritjen e shpenzimeve ka pasur kategoria e shpenzimeve komunale(arsyeja: borxhe të bartura nga viti 2022), mallrave dhe shërbimeve dhe paga e medijtje.

Buxheti i shpenzuar në periudhën Janar-Mars 2023 në shumën prej 2,238,489.97 € është 17.15 % e buxhetit në SIMFK krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetuar për vitin 2023. Nga Granti qeveritar janë shpenzuar 2,237,482.97€ (19.16 % në raport me buxhetin nga Granti), nga donacioni jashtëm – Save The Children 1,007.00 € (66.67% në raport me buxhetin nga donacioni).


Ndërsa nga totali i buxhetit të shpenzuar në këtë periudhë në shumën prej 2,238,489.97 € nga granti qeveritar janë shpenzuar 99.96% dhe nga donacioni 0.04 % . Krahasuar me vitin 2022 , shpenzimet për këtë periudhë janë më të larta për 8.69 % .

- ❖ **Shpenzimet për paga dhe medijtje** gjatë këtij tremujori, shënuan shpenzimin prej 1,735,380.33 €, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 25.70 % krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetuar për këtë kategori. Shpenzimet e pagave gjatë periudhës raportuese, paraqesin një rritje prej 14.42%, apo rreth 218,767.35 € më shumë krahasuar me shpenzimet e pagave në periudhën e njëjtë të vitit 2022. Ndikim në këtë rritje të shpenzimit ka pasur ndryshimi i koficientëve të pagave.
- ❖ **Shpenzimet në mallra dhe shërbime** kanë shënuar një rritje prej 28.40% krahasuar me vitin 2022. Gjatë kësaj periudhe shuma e këtyre shpenzimeve ka arritur në 354,560.83 €, kjo shumë korrespondon me 21.36% të buxhetit për këtë kategori. Shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve gjatë periudhës raportuese, paraqesin një rritje prej 28.40%, apo rreth 78,425.95 € më shumë krahasuar me shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve në periudhën e njëjtë të vitit 2022.
- ❖ **Shpenzimet në komunal**, kanë shënuar rritje prej 114.48% krahasuar me vitin 2022. Gjatë kësaj periudhe shuma e këtyre shpenzimeve ka arritur 80,024.61 €, kjo shumë korrespondon me 40.01% të buxhetit për këtë kategori. Shpenzimet e komunaleve gjatë periudhës raportuese paraqesin një rritje prej 114.87 % , apo rreth 42,781.47 € më shumë krahasuar me shpenzimet e komunaleve në periudhën e njëjtë të vitit 2022. Ndikim në këtë rritje të shpenzimeve ka qenë borgji i bartur i kësaj kategorie nga viti 2022.
- ❖ **Shpenzimet në subvencione dhe transfere**, shënuan shumën prej 13,650.00 € gjatë këtij tremujori, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 0.61% krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetuar për këtë kategori. Te subvencionet dhe transferet, gjatë periudhës raportuese paraqitet një rënie prej 33.41%, apo rreth 6,850.00€ më pak krahasuar me subvencionet dhe transferet në periudhën e njëjtë të vitit 2022.
- ❖ **Shpenzimet kapitale**, Shpenzimet kapitale arritën shumën prej 54,874.20 €, që është 1.36% krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetuar për këtë kategori. Shpenzimet kapitale gjatë periudhës raportuese paraqesin një rënie prej 73.74 % , apo rreth 154,126.73 € më pak në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2022.

2. Të hyrat buxhetore të komunës së Klinës për vitin 2023 duke përfshirë edhe të hyrat nga donatorët sipas burimit të financimit

Burimi i mjeteve	Buxheti sipas SIMFK për vitin 2023	% në total	Buxheti sipas SIMFK për vitin 2022	Ndryshimi 2023/2022 në %
Granti qeveritar	11.677.821.00	86.31	10,241,972.91	14.02
Të hyrat vetanake 2023	1.373.774.00	10.15	1,065,865.00	28.89
Të hyrat e bartura	0			
31 _ Granti I donatorëve të mbrendshëm	31.332.12	0.23	5,082.12	516.52
32 _ Granti I donatorëve të jashtme	18.341.33	0.14	-	
46 _ Save The Children	1.510.50	0.01	1,359.42	11.11
61 _ Granti I jashtëm (Performancës)	426.739.48	3.15		
TOTALI	13.529.518.43	100.00	11,314,279.45	19.58

Tabela 1. Buxheti Janar-Mars 2023 sipas burimit të financimit




Grafiku 1. Buxheti në SIMFK sipas burimit

3. Të hyrat vetanake (sipas llojeve) të realizuara për periudhën janar-mars 2023 dhe krahasimi me periudhën e njëjtë të vitit paraprak

Nr.	KODI EKONOMIK	LLOJET E TRANSAKSIONEVE	Tremujori 2022	% Ne total	Tremujori 2023	% Ne total	Krahasimi 2023/202	Ndryshimi ne €
1	40110	TATIMI NË PRONË	100.388.14	25.72	100.430.34	29.35	0.04	42.20
2	50001	TAKSË REGJISTRIMI I AUTOMJETEVE	17.010.00	4.36	19.445.00	5.68	14.32	2.435.00
3	50009	TAKSË PËR LEJE NDËRTIMI	176.638.01	45.26	113.132.55	33.06	-35.95	-63.505.46
4	50013	ÇERTIFIKATAT E LINDJES	363.00	0.09	167.00	0.05	-53.99	-196.00
5	50014	ÇERTIFIKATAT E KURORIZIMIT	1.00	0.00	-	0.00	-100.00	-1.00
6	50015	ÇERTIFIKATAT E VDEKJES	244.00	0.06	168.00	0.05	-31.15	-76.00
7	50016	ÇERTIFIKATA TJERA	8.561.20	2.19	9.371.00	2.74	9.46	809.80
8	50017	TAKSË VERIF. DOK.TË NDRYSHME	3.675.00	0.94	836.00	0.24	-77.25	-2.839.00
9	50019	TAKSA ADMINISTRATIVE	906.10	0.23	822.60	0.24	-9.22	-83.50
10	50024	ÇERTIFIKATAT MJEKSORE		0.00		0.00	#DIV/0!	0.00
11	50026	TAKSË PË LEGALIZIM		0.00	2.922.08	0.85	#DIV/0!	2.922.08
12	50029	TAKSË PËR USHTRIM TE VEPRIMTARISË	22.348.25	5.73	18.440.00	5.39	-17.49	-3.908.25
13	50032	TAKSË PËR FLETË POSEDUESE		0.00	5.082.00	1.49	#DIV/0!	5.082.00
14	50103	LARGIMI DHE DEPONIMI I AUTOMJE	1.039.50	0.27	345.00	0.10	-66.81	-694.50
15	50104	GJOBAT NGA INSPEKTORIATI	3.135.00	0.80	8.092.23	2.36	158.13	4.957.23
16	50205	LIC.PRANIM TEKNIK TE LOKALIT	1.215.00	0.31	1.626.50	0.48	33.87	411.50
17	50401	SHITJA E SHERBIMEVE		0.00		0.00	#DIV/0!	0.00
18	50403	TE HYRAT NGA SHITJA E MALLRAVE		0.00		0.00	#DIV/0!	0.00
19	50405	SHFRYTEZIMI I PRONES PUBLIKE	1.233.40	0.32	2.793.03	0.82	126.45	1.559.63
20	50406	PRONA PUB.PER TREG.TE HAPUR	1.000.00	0.26		0.00	-100.00	-1.000.00
21	50407	QIRAJA VENDOSJA OBJEKT TREGTAR	2.691.00	0.69	681.00	0.20	-74.69	-2.010.00
22	50408	QIRAJA NGA OBJEKTET PUBLIKE	6.309.00	1.62	8.118.06	2.37	28.67	1.809.06
23	50409	PARTICIPIM - SHENDETSIA	8.721.60	2.23	9.779.50	2.86	12.13	1.057.90
24	50409	PARTICIPIM - QERDHJA	6.237.36	1.60	7.760.00	2.27	24.41	1.522.64
25	50409	PARTICIPIM - ARSIMI I MESEM	11.239.00	2.88	18.280.00	5.34	62.65	7.041.00
26	50409	PARTICIPIM NGA GJEODEZIA		0.00	39.00	0.01	#DIV/0!	39.00
27	50504	TAX PER MATJEN TOKES NE TEREEN	17.284.00	4.43	13.888.00	4.06	-19.65	-3.396.00
		GJITHESEJT:	390.239.56		342.218.89		-12.31	-48.020.67

Tab.2. Të hyrat vetanake (sipas llojeve) të realizuara për periudhën janar-mars 2023 dhe krahasimi me periudhën e njëjtë të vitit paraprak

KRAHASIMI I TË HYRAVE VETANAKE NDËR VITE



Grafiku 2. Të hyrat vetanake sipas viteve

3.1. Realizimi i të hyrave vetanake për periudhën janar-mars 2023 sipas muajve

Nr.	KODI EKONOMIK	LLOJET E TRANSAKSIONEVE	Të hyrat janar 2023	Të hyrat shkurt 2023	Të hyrat mars 2023	Totali i të hyrave janar-mars 2023
1	40110	Tatimi ne prone	36.517.94	23.727.84	40.184.56	100430.34
2	50001	Taksa rrugore	6.690.00	5.780.00	6.975.00	19445.00
3	50009	Urbanizem	1.882.82	74.809.17	36.440.56	113132.55
4	50013	Çertifikatat e lindjes	32.00	9.00	126.00	167.00
5	50014	Çert. E kurorozimit	-	-	-	0.00
6	50015	Çertifikatat e vdekjes	-	55.00	113.00	168.00
7	50016	Çertifikatat tjera	3.274.00	2.866.00	3.231.00	9371.00
8	50017	Te hyrat tjera	372.00	-	464.00	836.00
9	50019	Taksa administrative	362.60	312.90	147.10	822.60
10	50026	Takë per legalizim	-	1.447.92	1.474.16	2922.08
11	50032	Taksë per flet posed.	1.389.00	1.217.00	2.476.00	5082.00
12	50103	Marimanga	-	345.00	-	345.00
13	50104	Denimet mandatore	5.500.00	150.00	2.442.23	8092.23
14	50205	Komisioni inspektues	233.00	465.00	928.50	1626.50
15	50029	Taksa nga licenca	4.040.00	4.660.00	9.740.00	18440.00
16	50401	Shitja e sherbimeve	-	-	-	0.00
17	50403	Shitja e pasurise	-	-	-	0.00
18	50405	Shfryt.pron.publike	1.383.03	150.00	1.260.00	2793.03
19	50406	Qer. per treg te hapur	-	-	-	0.00
20	50407	Qeraja e lokaleve	290.00	100.00	291.00	681.00
21	50408	Qeraja per banim	615.00	2.683.10	4.819.96	8118.06
22	50409	Participim - shendetsi	3.536.50	3.101.50	3.141.50	9779.50
23	50409	Participim - qerdhja	2.553.00	2.603.00	2.604.00	7760.00
24	50409	Participim - shp. F.A.	50.00	2.410.00	15.820.00	18280.00
25	50409	Participim nga gjeod.	9.00	18.00	12.00	39.00
28	50504	Kadaster & gjeodezi	3.010.00	3.786.00	7.092.00	13888.00
TOTALI			71.739.89	130.696.43	139.782.57	342.218.89

Tab.3. Të hyrat vetanake (sipas llojeve) të realizuara për periudhën janar-mars 2023 sipas muajve




Grafiku 3. Të hyrat sipas muajve

4. Shpenzimet buxhetore për periudhën janar-mars 2023 dhe krahasimi me vitin paraprak

Burimi i mjeteve	Buxheti sipas SIMFK për vitin 2023	%	Buxheti i shpenzuar Janar-Mars 2023	Progresi ndaj buxhetit në %	% në total e shpenzimeve Janar-Mars 2023	Buxheti i shpenzuar Janar-Mars 2022	Krahasimi i shpenz. 2023 me 2022 në %
Granti qeveritar	11.677.821.00	86.31	2.237.482.97	19.16	99.96	2.006.761.76	11.50
Të hyrat vetanake 2023	1.373.774.00	10.15	0			51.370.75	-100.00
Të hyrat e bartura	0		0				
31 _ Granti I donatorëve të mbrendshëm	31.332.12	0.23	0.00	0.00			0.00
32 _ Granti I donatorëve të jashtme	18.341.33	0.14					
46 _ Save The Children	1.510.50	0.01	1.007.00	0.24	0.04	1.359.42	-25.92
61 _ Granti I jashtëm (Performancës)	426.739.48	3.15					
TOTALI	13.529.518.43	100.00	2.238.489.97	16.55		2.059.491.93	8.69

Tabela 4. Shpenzimet buxhetore Janar-Mars 2023 krahasur me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar




Grafiku 4. Shpenzimet buxhetore Janar-Mars 2023 krahasur me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar

4.1 Shpenzimet e buxhetit në periudhën janar-mars 2023 sipas kategorive ekonomike

Përshkrimi	Buxheti në SIMFK	Shpenzimet Janar-Mars	Progresi ndaj buxhetit në %	%-në total e shpenz. Janar-Mars 2023	Shpenzimet Janar-Mars	Krahasimi i shpenzimeve 2023 me 2022 në %
	2023	2023			2022	
Paga dhe mëditje	6,753,688	1,735,380.33	25.70	77.52	1,516,612.98	14.42
Mallra dhe shërbime	1,660,000	354,560.83	21.36	15.84	276,134.88	28.40
Shërbime komunale	200,000	80,024.61	40.01	3.57	37,243.14	114.87
Subvencione dhe transf.	400,000	13,650.00	3.41	0.61	20,500.00	-33.41
Kapitalet	4,037,907	54,874.20	1.36	2.45	209,000.93	-73.74
TOTALI	13,051,595	2,238,489.97	17.15	100	2,059,491.93	8.69

Tabela 5. Shpenzimet buxhetore janar-mars 2023 sipas kategorive ekonomike

Shpenzimet Janar-Mars 2023 sipas kategorive ekonomike



Grafiku 4.1. Shpenzimet buxhetore në periudhën Janar – Mars 2023 sipas kategorive ekonomike

Nga buxheti i shpenzuar në periudhën janar – mars 2023 në shumën prej 2,238,489.97 €:

- Për paga dhe medijtje janë shpenzuar 1,735,380.33 € (25.70 % në raport me buxhetin e alokuar për paga)
- Për mallra e shërbime janë shpenzuar 354,560.83 € (21.36 % në raport me buxhetin e alokuar për mallra e shërbime)
- Për shërbime komunale janë shpenzuar 80,024.61€ (40.01% në raport me buxhetin e alokuar për shërbime komunale)
- Për subvencione janë shpenzuar 13,650.00 € (3.41 % në raport me buxhetin e alokuar për subvencione) dhe
- Për shpenzime kapitale 54,874.20 € (1.36% në raport me buxhetin e alokuar për shpenzime kapitale).

Ndërsa nga totali i buxhetit të shpenzuar në këtë periudhë në shumën prej 2,238,489.97 €, për paga e medijtje janë 77.52 % e shpenzimeve, për mallra dhe shërbime 15.84 % e shpenzimeve, për shërbime komunale 3.57 % e shpenzimeve, për subvencione 0.61 % e shpenzimeve dhe për kapitale 2.45 % e shpenzimeve.

Shpenzimet në periudhën Janar-Mars 2023 në shumën prej 2,238,489.97 € krahasuar me shpenzimet për periudhën e njëjtë të vitit 2022 në shumën prej 2,059,491.93 € janë më të larta për 8.69 % . Shpenzimet për paga dhe medijtje krahasuar me vitin paraprak janë më të larta për 14.42%, shpenzimet për mallra dhe shërbime janë më të larta për 28.40%, shpenzimet për shërbime komunale janë më të larta për 114.87 %, shpenzimet për subvencione janë më të ulta për 33.41 % dhe shpenzimet kapitale janë më të ulta për 73.74 %.

5. Shpenzimet buxhetore për periudhën janar-mars 2023, raportit të shpenzimeve analitike sipas kodeve buxhetore në SIMFK

Nr. rend.	Kodi ekonomik	Përshkrimi	Shpenzimet Janar-Mars /2023	Shpenzimet janar- mars /2022	Ndryshimi
1	11110	PAGAT NETO PERMES LISTAVE	1,471,004.48	1,269,951.41	201,053.07
2	11115	PAGESA PËR SINDIKATË	2,793.92	6,699.40	-3,905.48
3	11125	ANTARSIM-ODA E INFERMIERVE TE KOSOVËS	567.68	592.62	-24.94
4	11126	ANTARSIM-ODA E MJEKVE TE KOSOVËS	2,160.00	1,920.00	240.00
5	11400	PUNT. ME KONT.(JO NË LISTË TË PAGAVE)	864.38	1,171.14	-306.76
6	11500	TATIMI NE TARDHURA PERSONALE	93,325.03	73,615.52	19,709.51
7	11600	KONTRIBUTI PENSIONAL I PUNETORI	82,332.42	71,114.91	11,217.51
8	11700	KONTRIBUTI PENSIONAL I PUNEDHENSI	82,332.42	71,114.91	11,217.51
9	11900	PAGESA PËR VENDIME GJYQËSORE	-	20,433.07	-20,433.07
	TOTALI: 11	RROGAT DHE PAGAT	1,735,380.33	1,516,612.98	218,767.35
10	13130	SHPEN.UDHTIMIT BRENDA	7,179.41	10,839.90	-3,660.49
11	13310	SHPENZ. PËR INTERNET	-	744.58	-744.58
12	13320	SHPENZ.E TELEFONIT-VALA 900	2,713.83	1,608.32	1,105.51
13	13330	SHPENZIMET POSTARE	166.40	116.5	49.90
14	13430	SHËRBIME TË NDRYSHME SHËNDETSORE	47,746.60	0.00	47,746.60
15	13450	SHËRBIME SHTYPJE - JO MARKETING	3,987.61	4,898.06	-910.45
16	13460	SHERB.KONTRAKTUESE TJERA	52,467.20	91,613.76	-39,146.56

17	13470	SHERBIME TEKNIKE			
			800.00	800	0.00
18	13480	SHPENZIMET PER ANETARESIM			
			5,872.00	0	5,872.00
19	13490	SHERBIMET E VARRIMIT			
			185.00	630	-445.00
20	13501	MOBILJE (ME PAK SE 1000 Euro)			
			-	1,420.60	-1,420.60
21	13509	PAISJE TJERA<1000 EURO			
			2,404.00	4,212.73	-1,808.73
22	13610	FURNIZIME PER ZYRE			
			4,689.77	5,712.17	-1,022.40
23	13620	FURNIZIM USHQIM&PIJE(JO DREKA)			
			4,197.60	6,893.04	-2,695.44
24	13630	FURNIZIME MJEKSORE			
			16,126.87	17,108.88	-982.01
25	13640	FURNIZIM PASTRIMI			
			2,100.01	3,732.69	-1,632.68
26	13650	FURNIZIME ME VESHMBATHJE			
			901.00	0.00	901.00
27	13720	NAFT PER NGROHJE QENDRORE			
			-	14,890.90	-14,890.90
28	13760	DRU			
			20,888.00	45,916.60	-25,028.60
29	13770	DERIVATE PER GJENERATOR			
			523.63	416.36	107.27
30	13780	KARBURANTE PER VETURA			
			13,106.60	10,895.11	2,211.49
31	13820	AVANC PËR UDHËTIME ZYRTARE			
			208.00	0	208.00
32	13950	REGJ.SIGURIMI I AUTOMJETEVE			
			340.00	660	-320.00
33	13951	REGJ.SIGURIMI I AUTOMJETEVE			
			913.46	1,730.31	-816.85
34	13953	SIGURIMI I NDERTESAVE TJERA			
			1,260.24	0.00	1,260.24
35	14010	MIRM.RIPARIMI I AUTOMJETEVE			

			4,135.61	8,199.31	-4,063.70
36	14020	MIRMBAJTJA E NDERTESAVE			
			1,480.32	0	1,480.32
37	14023	MIRMBAJTJA E SHKOLLAVE			
			16,401.22	9,653.08	6,748.14
38	14024	MIRËMBAJTJA OBJEKTEVE SHËNDETËSORE			
			-	983	-983.00
39	14032	MIRMBAJTJA ERRUGEVE LOKALE			
			122,990.30	20,565.45	102,424.85
40	14040	MIRMB.TEKNO.INFORMATIVE			
			-	127.63	-127.63
41	14050	MIRMB.PAISJEVE DHE MOBILEVE			
			18,314.30	10,988.00	7,326.30
42	14120	QIRAJ S PER TOKE			
			482.25	0	482.25
43	14210	REKLAMAT DHE KONKURSET			
			500.00	500	0.00
44	14230	SHPENZIMET PËR INFORMIM PUBLIK			
			850.00	0	850.00
45	14310	DREKAT ZYRTARE			
			629.60	277.9	351.70
46	14410	SHPENZIME-VENDIMET E GJYKATAVE			
	TOTALI: 13	MALLRA DHE SHERBIME			
			354,560.83	276134.88	78425.95
47					
	13210	RRYMA	47,379.92	34,766.07	12,613.85
48					
	13220	UJI	1,084.63	1,292.33	-207.70
49					
	13230	MBETURINAT	30,692.77	1,184.74	29,508.03
50	13250	SHPENZIMET TELEFONIKE	867.29		867.29
	TOTALI: 14	SHPENZIMET KOMUNALE			
			80,024.61	37,243.14	42,781.47
51	21200	SUB.PER ENTITETET JOPUBLIKE			
			13,650.00	20,500.00	-6,850.00
	TOTALI: 20	SUBVENCIONET DHE TRANSFERET			
			13,650.00	20,500.00	-6,850.00

52	31120	NDËRTESTAT ADMINISTRATËS AFARISTE	-	13,000.00	-13,000.00
53	31121	OBJEKTET ARSIMORE	-	16,044.00	-16,044.00
54	31124	OBJEKTET SPORTIVE			0.00
55	31230	NDERTIMI I RRUGEVE LOKALE	45,374.20	139,454.37	-94,080.17
56	31250	KANALIZIMI	-	9,341.11	-9,341.11
57	31260	UJESJELLES	9,500.00		9,500.00
58	31690	PAJISJE TJERA			0.00
59	32000	INVESTIMET NE VIJIM	-	31,161.45	-31,161.45
	TOTALI: 30	PASURIT JO FINANCIARE	54,874.20	209,000.93	-154,126.73
TOTALI I PERGJITHSHEM:11,13,14,20,30			2,238,489.97	2,059,491.93	178,998.04

Klinë, 4.04.2023


Zyrtarja Kryesore Financiare

Melihate Behramaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

STATUTI

I

QENDRËS KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE “NËNË TEREZA”

STATUTE

of the

MAIN FAMILY MEDICINE CENTER “MOTHER TERESA”

STATUT

GLAVNOG CENTRA PORODIČNE MEDICINE “MAJKA TEREZA”

<p>Kompetencat e Kuvendit Komunal,</p> <p>Në mbështetje të nenit 45, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Shëndetësi Nr. 04/L-125,</p> <p>Miraton:</p> <p style="text-align: center;">STATUTIN E QENDRËS KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE “ NËNË TEREZA” NË KLINË</p> <p style="text-align: center;">Neni 1 I - Dispozitat e përgjithshme</p> <p>Me këtë Statut rregullohen: dispozitat e përgjithshme, emërtimi dhe selia, veprimtaria e QKMF-së, statusi juridik, përfaqësimi dhe prezantimi, struktura e institucionit, udhëheqja dhe trupat e institucionit, zhvillimi i vazhdueshëm institucional, mbikëqyrja e QKMF-së, aktet e përgjithshme të QKMF, pronësia dhe financimi, transparenca në punë, konfidenca profesionale dhe afariste, organizimi sindikal, mbikëqyrja e brendshme dhe dispozitat kalimtare dhe përfundimtare lidhur me ushtrimin e veprimtarisë së kujdesit shëndetësor në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (në tekstin e mëtejme: QKMF).</p>	<p>Competencies of the Municipal Assembly,</p> <p>Pursuant to Article 45, paragraph 1 and 2 of Law No. 04/L-125 on Health,</p> <p>Adopts the following:</p> <p style="text-align: center;">STATUTE OF THE MAIN FAMILY MEDICINE CENTER “MOTHER TERESA” IN KLINA</p> <p style="text-align: center;">Article 1 I – General provisions</p> <p>This Statute regulates: general provisions, designation and headquarter, activity of MFMC, legal status, representation and presentation, structure of the institution, leadership and bodies of the institution, continuous institutional development, supervision of MFMC, general acts of MFMC, ownership and financing, transparency at work, professional and business confidence, trade union organization, internal supervision and transitional and final provisions relating to the exercise of healthcare activity in the Main Family Medicine Center (hereinafter: MFMC).</p>	<p>Nadležnosti Skupštine Opštine,</p> <p>Na osnovu člana 45, stavke 1. i 2. Zakona o zdravlju br. 04/L-125,</p> <p>Usvaja:</p> <p style="text-align: center;">STATUT GLAVNOG CENTRA PORODIČNE MEDICINE “MAJKA TEREZA” U KLINI</p> <p style="text-align: center;">Član 1 I - Opšte odredbe</p> <p>Ovim Statutom se uređuju: opšte odredbe, naziv i sedište, delovanje GCPM-a, pravni status, zastupanje i prikazivanje, struktura institucije, rukovodstvo i tela institucije, kontinuirani institucionalni razvoj, nadzor GCPM-a, opšti akti GCPM-a, vlasništvo i finansiranje, transparentnost u radu, profesionalna i poslovna poverljivost, sindikalno organizovanje, unutrašnji nadzor i prelazne i konačne odredbe u vezi sa sprovođenjem delatnosti primarne nege u Glavnom centru porodične medicine (u daljnjem tekstu: GCPM).</p>
---	---	---

<p style="text-align: center;">Neni 2 Statusi i QKMF</p> <p>1.QKMF-ja ka statusin e personit juridik publik, me cilësi të autoritetit punëdhënës, ku organizohet, ofrohet dhe zbatohet Kujdesi Parësor Shëndetësor Publik (në tekstin e mëtejshëm: KPSH).</p> <p>2.Themelues i QKMF-së është Kuvendi Komunal i Klinës.</p> <p>3.QKMF-ja në Klinë ka filluar punën në vitin 1948.</p>	<p style="text-align: center;">Article 2 MFMC Status</p> <p>1.The MFMC has the status of a public legal entity, having the quality of the employing authority, where the Public Primary Healthcare is organized, provided and implemented (hereinafter: PHC).</p> <p>2.The founder of the MFMC is the Municipal Assembly of Klina.</p> <p>3.The MFMC (the name of respective municipality) has started the work in(the year).</p>	<p style="text-align: center;">Član 2 Status GCPM</p> <p>1.GCPM ima status javnog pravnog lica, u svojstvu autoriteta poslodavca, gde se organizuje, pruža i primenjuje Javna Primarna zdravstvena nega (u daljnjem tekstu: PZN).</p> <p>2.Osnivač GCPM je Skupština Opštine Klina.</p> <p>3.GCPM u (naziv dotične opštine) je počeo sa radom ... godine.</p>
